



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0418

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) GËRLICA - COMPANY SH. P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugëve IV LLOTE" me numër të prokurimit 616-23-269-5-1-1, me 28/09/2023, mori:

Vendim

- Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE GËRLICA - COMPANY SH. P.K. me nr. 2023/0418, e datës 20/06/2023, kurse vendimi i AK Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugëve IV LLOTE" për Lot III, me numër të prokurimit 616-23-269-5-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
- Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
- Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale

Me 20.02.2023, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i rrugëve IV Lote" me nr. të prokurimit: 616-23-269-5-1-1.

Me datën 27.06.2023, AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës.

Operatori ekonomik “Gerlica-Company sh.p.k” ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim me datën 07.06.2023, ndërsa AK është përgjigje në kërkesën për rishqyrtim me datën 10. 06. 2023 duke e refuzuar të njëjtën.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Gerlica-Company sh.p.k”, me datën 20.06.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0418, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Vlerësimi dhe administrimi i provave

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 17.07.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues te aprovohet si bazuar;
- të anulohet vendimi i AK dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

(a) Pohimet ankimore të OE “Gerlica-Company sh.p.k” dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesor ankimor sipas ankesës i nr.420/23 është se AK me rastin e vlerësimit dhe krahasimit t i ofertave nuk e ka bërë poentimin në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit, më konkretisht me kriterin për dhënie të kontratë ekonomikisht më i favorshëm, ku poentimi është dashtë të bëhet:

Grupi 3. LLOT III-Rekonstruimi i rrugëve ne Bardhosh

Çmimin më te ulët: ekonomikisht më i favorshëm:

	Nën-kriteri	Koeficient
1	cmimi	0.60

2	Afati me i shkurt i implementimit nga data e nënshkrimit te kontratës deri ne max 60 dite	0.20
3	Afati me i gjate i Periudhës Garantuese deri ne max 5 vite	0.20

Kriteri i dhënies se kontratës për ndërtim te rrugëve:

1. Çmimi
2. Afati i implementimit
3. Periudha garantuese

Kategoritë	Përshkrimi i kritereve	Pesh	Metoda e Vlerësimit
1	Çmimi	60%	
2	Afati me i shkurt i implementimit nga data e nënshkrimit te kontratës deri ne max 90 dite	20%	
3	Afati me i gjate i Periudhës Garantuese deri ne max 10 vite	20%	

100
%

Me rastin e analizimit të raportit të vlerësimit nga komisioni vlerësues kemi gjetur këtë tabelë sa i përket poentimitit i OE-ve për lot.3.

Siç shihet nga tabela më lart, poentimi nuk është bërë në pajtim me kriteret e përcaktuara nga vet OE, ku tek garancioni të gjithë OE-te kanë 0 (zero) pikë, mirë po edhe tek P.D vetëm 2 OE kanë i pikë të shënuara.

Një poentim i tillë nuk është në pajtim me vetë formulën e përcaktuar nga AK, andaj rekomandimi jonë është që lënda të kthehet në rivlerësim dhe me rastin e rivlerësimit të zbatohet kriteri dhe nën kriteret ashtu siç janë përcaktuar nga vet AK

Konstatohet në vijim, se raporti i cituar si më sipër është pranuar nga të gjitha palët, me ç 'rast AK ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues ndërsa OE është pajtuar.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhenë shpjegime me pohimet ankimore.

Arsyet se pse ankesa e OE ankues klasifikohet si pjesërisht e bazuar ëshë sepse AK nuk ka ofruar fakte për panelin shqyrtues për mënyrën e vlerësimit të ofertave. Për këto fakte OSHP me emailin e dt. 21.09.2023,iu është drejtuar AK duke kërkuar sqarime paneli shqyrtues ka nevoj për informacione më të detajuara sa i përket metodologjisë së poentimit të përdorur nga Komisioni I Vlerësimit për nënkriteret e vendosura ne Dosje te Tenderit. Arsyet pse Plani Dinamik i ofruar nga OE ankues është vlerësuar me 0 pikë, ndërsa OE ankues ditët e ofruara në Plan dinamik I ka

Brenda kornizës së kërkuar si dhe nuk ka ndryshim të madh të diteve në raport me planin dinamik të OE të rekomanduar. Por në lidhje me këtë email OSHP nuk ka pranuar ende përgjigje. Kështu që, paneli shqyrtues e mbështet arsyetimin e dhënë nga eksperti shqyrtues që lënda të kthehet në ri-vlerësim por ankesa të klasifikohet si pjesërisht e bazuar sepse nuk kemi fakte dhe argumentet se Një i poentim i tillë është/apo nuk është në pajtim me vetë formulën e përcaktuar nga AK, andaj rekomandimi jonë është që me rastin e rivlerësimit të zbatohet kriteri dhe nën kriteret ashtu siç janë përcaktuar nga vet AK.

- Përfundim -

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - GËRLICA - COMPANY SH. P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: